



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



Kuvendi i Komunës

Nr. 02/____

Datë: 11.07.2017

Në bazë të nenit 43 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, dhe në pajtim me Statutin e Komunës së Malishevës, miratuar në mbledhjen e Kuvendit të Komunës me datë: 31.10.2008 (nr.01/871, datë 12.11.2008)

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës me datë: 11/07/2017 ;

T H Ë R R E T

Mbledhjen e -VII- (shtatë) të rregullt të Kuvendit të Komunës së Malishevës për vitin 2017, e cila do të mbahet ditën e **Mërkurë** me datë: 19.07.2017 duke filluar nga ora 10:00.

Mbledhja do të mbahet në sallën e Kuvendit të Komunës.

Ftohet z/zj. _____ që të marr pjesë në këtë mbledhje.

Për këtë mbledhje propozoj këtë,

R E N D I T E

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Shqyrtimi i raportit të Auditimit për raportin financiar vjetor të Komunës së Malishevës, për vitin e përfunduar me 31 Dhjetor 2016.
3. Shqyrtimi i kërkesës nr.01/839 datë:11.07.2017 të Kryetarit të Komunës, dhe marrja e vendimit për lejim të mjeteve financiare për organizimin e Festivalit Folklorik “Oda e Llapushës” i cili do të organizohet me 1 dhe 2 Gusht 2017.
4. Shqyrtimi i kërkesës nr.01/824 datë:11.07.2017 të Kryetarit të Komunës, dhe marrja e vendimit për lejim të mjeteve financiare për subvencionim të Klubit të Futbollit “UV-Malisheva”.
5. Shqyrtimi i Raportit të Drejtorisë për Arsim dhe Edukim, për përfundimin e vitit shkollor 2016/2017.
6. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të punës të Komitetit për Komunitete për vitin 2016.
7. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës të Komitetit për Komunitete për vitin 2017.
8. Njoftimi në lidhje me projektin e asfaltimit të rrugës së transitit të vogël në Malishevë (e përsëritur).
9. Shqyrtimi i raportit nr.02/113 datë:20.04.2017 të Komisionit për verifikimin e dhënies në shfrytëzim të pronës publike prej Qeverisë së përkohshme deri me 2015 (e përsëritur).
10. Shqyrtimi i Peticionit të parashtruar nga banorët e lagjes së “Gurit” në Malishevë (e përsëritur).
11. Të ndryshme.

Ardhja e juaj është e domosdoshme.

Malishevë Korrik-2017

Kryesuesi i Kuvendit
Dr. Aziz Thaçi